



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.154

16 nëntor

2009

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 171 datë 22.10.2009	Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë	6919
Ligj nr.10 172 datë 22.10.2009	Për disa shtesa në ligjin nr.9157, datë 4.12.2003 “Për përgjimin e telekomunikacioneve”	6924
Ligj nr.10 173 datë 22.10.2009	Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë	6925
Vendim i Kuvendit nr.6, datë 5.11.2009	Për zgjedhjen e dy anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit	6936
Vendim i Kuvendit nr.7, datë 5.11.2009	Për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit	6936
Vendim i Kuvendit nr.8, datë 5.11.2009	Për lirimimin nga detyra të anëtarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, zotit Detar Hysi	6937
Vendim i GJK nr.29, datë 21.10.2009	Me objekt: 1. Interpretimi i pikës 1 të nenit 78 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. 2. Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit të publikuar të Kuvendit të Shqipërisë, nr. 190, datë 16.06.2008 “Për mosdhënien e pëlqimit për emërimin e z. Zamir Poda si anëtar i Gjykatës së Lartë”. 3. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr. 190, datë 16.06.2008 “Për mosdhënien e pëlqimit për emërimin e z. Zamir Poda si anëtar i Gjykatës së Lartë” deri në dhënien e vendimit përfundimtar.....	6937

LIGJ
Nr.10 171, datë 22.10.2009

PËR PROFESIONET E RREGULLUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të profesioneve të rregulluara në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është:

a) përcaktimi i kriterëve për ushtrimin e disa profesioneve të rëndësishme, të cilat lidhen me mbrojtjen e interesit publik, të sigurisë publike dhe të shëndetit, duke respektuar parimin e shqyrtimit të pavarur dhe autonomisë së profesionistëve;

b) mbrojtja dhe garantimi i standardeve për disa profesione të rëndësishme, në mënyrë që ushtrimi i tyre të bëhet prej personave të kualifikuar, të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara nga ky ligj apo ligje të tjera.

Neni 3
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për çdo person, i cili kërkon të ushtrojë një profesion të rregulluar në Republikën e Shqipërisë.

2. Ky ligj nuk zbatohet:

a) për veprimtaritë e ushtruara në profesionin e rregulluar, që lidhen me kryerjen e funksioneve në autoritetet gjyqësore.

b) për profesionet, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, kanë kërkesa të veçanta, por jo domosdoshmërisht të karakterit të formimit apo kualifikimit të kërkuar për profesionet e rregulluara.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Profesion i rregulluar” është një veprimtari apo grup veprimtarish profesionale, e drejta e ushtrimit të të cilave ose njëra nga format e ushtrimit rregullohet me ligj apo me akte nënligjore dhe kushtëzohet me një nivel të caktuar formimi ose me zotërimin e kualifikimeve profesionale të veçanta.

b) “Kualifikime profesionale” janë kualifikimet e certifikuara me një titull studimi, një dëshmi aftësie ose një përvojë profesionale.

c) “Dokument zyrtar i formimit apo kualifikimit profesional” është diploma, certifikata ose dëftesa, lëshuar nga autoriteti kompetent, në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, që certifikon përfundimin e suksesshëm të një formimi apo kualifikimi profesional, të zhvilluar brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

ç) “Autoritet kompetent” është çdo autoritet, i ngarkuar me akt ligjor apo nënligjor, si përgjegjës e rregullator për një apo më shumë profesione të rregulluara, për njohjen e së drejtës së ushtrimit të tyre, për pranimin e aplikimeve, të deklarimeve dhe marrjen e vendimeve.

d) “Përvojë profesionale” është ushtrimi i ligjshëm i një profesioni, për një periudhë të caktuar kohe, të parashikuar në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, me ligj apo me akt nënligjor.

dh) “Praktikë profesionale” është ushtrimi i një profesioni të rregulluar për një periudhë të caktuar kohe nga ana e praktikantit, në drejtimin e përgjegjësinë e një profesionisti të kualifikuar, që mund të shoqërohet me një formim shtesë, sipas mënyrës së përcaktuar nga autoriteti kompetent, në bashkëpunim me urdhrin profesional përkatës.

e) “Provim i shtetit” është kontrolli vetëm për njohuritë profesionale të kandidatit, që organizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ky provim kryhet sipas përcaktimeve të parashikuara në këtë ligj dhe vlerëson njohuritë dhe aftësitë e kandidatit për ushtrimin e një profesioni të rregulluar.

ë) “Kandidat” është personi, i cili gëzon një dokument zyrtar të formimit apo kualifikimit profesional dhe që kandidon për të marrë titullin e një profesioni të rregulluar.

f) “Urdhër profesional”, më poshtë UP, është enti publik kombëtar, i cili përfaqëson interesat e përbashkëta të profesioneve në një fushë të caktuar dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre, në funksion të publikut.

Neni 5

Profesionet e rregulluara

1. Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë janë profesioni i:

- a) mjekut;
- b) stomatologut;
- c) farmacistit;
- ç) infermierit;
- d) mamisë;
- dh) fizioterapistit;
- e) veterinerit;
- ë) arkitektit;
- f) inxhinierit.

2. Profesione të rregulluara janë edhe profesionet e përcaktuara si të tilla me ligje të tjera, të veçanta.

KREU II

KUSHTET DHE KRITERET PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË RREGULLUAR

Neni 6

Ushtrimi i profesionit të rregulluar

1. Të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar e ka çdo person, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligj ose në ligje të tjera, të veçanta.

2. Profesionin ushtrohet si person fizik ose juridik, me cilësinë e të vetëpunësuarit ose të të punësuarit, sipas kërkesave të përcaktuara nga UP-ja përkatëse.

3. Ushtrimi i një profesioni të rregulluar bëhet në përputhje me parimet e mëposhtme:

- a) liria e konkurrencës së profesionistëve;
- b) autonomia dhe pavarësia e gjykimit intelektual e teknik të profesionistit;
- c) korrektësia dhe cilësia e shërbimeve për mbrojtjen e përfituesit të shërbimit e të interesave publikë, duke garantuar ushtrimin korrekt e ligjor të profesionit, pavarësisht nga mënyra apo forma e ushtrimit të tij;
- ç) liria e zgjedhjes nga përfituesi i shërbimit.

Neni 7

Formimi dhe kualifikimi profesional për ushtrimin e profesionit të rregulluar

Personi, që kërkon të ushtrojë një profesion të rregulluar, duhet të ketë përfunduar programin përkatës të akredituar të studimit dhe/ose kualifikime profesionale në atë profesion, të cilat vërtetohen me dokumente zyrtare, të lëshuara brenda ose jashtë vendit dhe të njohura në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 8

Kriteret për ushtrimin e një profesioni të rregulluar

1. Për të fituar të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, çdo kandidat duhet:
 - a) të kryejë praktikën profesionale;
 - b) të kryejë provimin e shtetit;
 - c) të regjistrohet në UP-në përkatëse.
2. Etapat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni përcaktohen nga autoriteti kompetent përkatës, sipas veçantive të çdo profesioni të rregulluar.

Neni 9

Provimi i shtetit

1. Provimi i shtetit:
 - a) realizon garancitë publike për përgjegjësitë, që sjell ushtrimi i një profesioni të rregulluar.
 - b) kryen testimin e njohurive të kandidatit, që aspiron ushtrimin e një profesioni të rregulluar, duke siguruar uniformitet në vlerësimin e kandidatëve, në nivel kombëtar, përmes verifikimit të aftësive të nevojshme profesionale, sipas specifikave të çdo profesioni.
2. Përmbajtja e provimit të shtetit hartohet në përputhje me fushën e veprimtarisë profesionale.
3. Pas përfundimit me sukses të provimit të shtetit, kandidatit i jepet titulli profesional përkatës.
4. Përjashtohet nga detyrimi për të dhënë provimin e shtetit:
 - a) profesionisti që, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ushtron ose ka ushtruar një profesion të rregulluar;
 - b) profesionisti, i cili fiton të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar jashtë Republikës së Shqipërisë, në përputhje me përcaktimet e Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Organizimi i provimit të shtetit

1. Provimi i shtetit organizohet dhe zhvillohet nga ministria që mbulon fushën e arsimit, në bashkëpunim me autoritetin kompetent përkatës.
2. Me urdhër të ministrit që mbulon fushën e arsimit dhe të autoritetit kompetent përkatës ngrihet Komisioni i Provimit të Shtetit, me këtë përbërje:
 - a) një përfaqësues i caktuar nga ministri që mbulon fushën e arsimit;
 - b) një përfaqësues i autoritetit kompetent;

- c) një përfaqësues, anëtar i UP-së përkatëse;
 - ç) dy përfaqësues nga personeli akademik i universiteteve, të akredituara për programin përkatës të studimit të profesionit të rregulluar, të cilët kanë titullin shkencor “Profesor” dhe kanë, të paktën, 10 vjet përvojë pune në institucionet e arsimit të lartë.
3. Anëtarët e përcaktuar në shkronjat “c” dhe “ç” të pikës 2 të këtij neni emërohen sipas mënyrës së mëposhtme:
- a) UP-ja i propozon autoritetit kompetent të paktën dy kandidatura, prej të cilave zgjidhet përfaqësuesi i përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 2 të këtij neni;
 - b) Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës i propozon ministrit që mbulon fushën e arsimit, të paktën, katër kandidatura, prej të cilave përzgjidhen dy përfaqësuesit e përcaktuar në shkronjën “ç” të pikës 2 të këtij neni.
4. Në rast se përfaqësimi i UP-së në Komisionin e Provimit të Shtetit nuk është i mundur, autoriteti kompetent përfaqësohet me një anëtar shtesë.
5. Kryetari i Komisionit të Provimit të Shtetit është përfaqësuesi i përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 2 të këtij neni.
6. Kriteret për përzgjedhjen e përfaqësuesve të përmendur në pikën 2 të këtij neni përcaktohen me urdhër të ministrit që mbulon fushën e arsimit, në bashkëpunim me autoritetin kompetent të fushës përkatëse.
7. Ministri që mbulon fushën e arsimit përcakton rregullat për funksionimin e Komisionit të Provimit të Shtetit, shpërblimin e anëtarëve të tij, si dhe procedurat dhe mënyrën e zhvillimit të provimit të shtetit.
8. Tematika, mënyra e zhvillimit dhe administrimi, përmes teknologjisë dixhitale të provimit të shtetit, përcaktohen me urdhër të ministrit që mbulon fushën e arsimit, pas këshillimeve me autoritetin kompetent.

Neni 11

Praktika profesionale

1. Praktika profesionale synon përvetësimin efektiv të njohurive teknike, praktike dhe etike të profesionit, mënyrat e së cilës përcaktohen nga autoriteti kompetent, me propozimin e UP-së përkatëse.
2. Praktika profesionale zhvillohet nën drejtimin e një profesionisti, person fizik apo juridik.
3. UP-ja përkatëse, nëpërmjet strukturave të veta, siguron që praktika të kryhet nën drejtimin e një profesionisti, i cili e ushtron profesionin prej jo më pak se tre vjetësh dhe jep garanci të mjaftueshme për përgatitjen teoriko-praktike të praktikantit.
4. Gjatë zhvillimit të praktikës profesionale, praktikantit i jepet një pagesë prej jo më pak se 50 (pesëdhjetë) për qind të rrogës bazë.
5. Pagesa apo shpërblimi vlerësues bëhet nga profesionisti, i cili drejton praktikën profesionale.
6. Përfashtohet nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale çdo individ, i cili provon se, për një periudhë të caktuar dhe në përputhje me kriteret specifike të një profesioni të rregulluar, ka qenë i angazhuar në një veprimtari profesionale, brenda ose jashtë vendit, që i ka dhënë mundësi të përvetësojë një përvojë profesionale të mjaftueshme në fushën e këtij profesioni.
7. Autoriteti kompetent, në bashkëpunim me UP-në përkatëse, përcakton kriteret, që përdoren për të vlerësuar nëse përvoja profesionale e kandidatit është e mjaftueshme për ta përjashtuar nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale, përmes një vendimi përfundimtar.

Neni 12

Regjistrimi në urdhrin profesional

Çdo profesionist, për të fituar të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, regjistrohet në urdhrin profesional përkatës.

KREU III AUTORITETET PËRGJEGJËSE

Neni 13 **Kompetencat e Këshillit të Ministrave**

Këshilli i Ministrave, me propozimin e autoritetit kompetent, përcakton:

- a) kërkesat minimale për formimin dhe kualifikimet profesionale për profesionet e rregulluara;
- b) listën e specialiteteve, të nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara.

Neni 14 **Autoriteti kompetent**

Autoriteti kompetent për profesionet e rregulluara në një fushë të caktuar është ministria që mbulon fushën përkatëse.

Neni 15 **Urdhri profesional**

1. Misioni i UP-së është ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesionit të rregulluar, si dhe mbrojtja e publikut nga kequshtrimi i profesionit.
2. Personat që ushtrojnë një profesion të rregulluar organizohen në një UP, pa përjashtuar anëtarësimin në sindikata.
3. Organizimi dhe funksionimi i urdhrit profesional bëhet me ligj të veçantë.

KREU IV PËRGJEGJËSITË E PROFESIONISTIT

Neni 16 **Përgjegjësitë e profesionistit**

Profesionisti ka detyrime:

- a) të respektojë ligjet dhe kodin etik profesional;
- b) të bëjë të njohur për publikun titullin profesional të tij;
- c) të kujdeset për përditësimin e aftësive të veta profesionale;
- ç) të vërë në dijeni UP-në përkatëse për situata të mundshme të konfliktit të interesit, lidhur me shërbimin e kërkuar;
- d) të vërë në dijeni përfituesin e shërbimit për anëtarësinë e tij në UP-në përkatëse dhe të japë të dhëna për përvojën e tij profesionale, si dhe për situatat e mundshme të konfliktit të interesit, lidhur me shërbimin e kërkuar.

Neni 17 **Kodi etik profesional**

1. Kodi etik profesional, përmbajtja e të cilit duhet të jetë lehtësisht e kuptueshme nga të tretët, disiplinon ushtrimin e veprimtarisë profesionale të çdo profesionisti.
2. Kriteret dhe procedurat e hartimit të kodit etik profesional përcaktohen nga organet kombëtare të UP-së.
3. Kodi etik profesional udhëhiqet nga këto parime:
 - a) mbrojtja e interesave publikë, nëpërmjet ushtrimit korrekt të profesionit;
 - b) mbrojtja e besimit dhe e zgjedhjes së lirë nga përfituesi i shërbimit;

- c) sigurimi i cilësisë së shërbimeve profesionale;
 - ç) sigurimi i të dhënave të duhura për përmbajtjen dhe mënyrat e ushtrimit të shërbimeve profesionale.
4. Kodi etik publikohet dhe përditësohet periodikisht nga UP-ja përkatëse.

Neni 18
Masat disiplinore

1. Profesionisti, që shkel detyrimet e parashikuara në këtë ligj, në ligje të veçanta, që rregullojnë fushën e veprimtarisë së tij, apo në kodin etik profesional ndëshkohet me masë administrative.

2. Llojet e masave administrative, autoriteti përgjegjës, procedurat e dhënies, të ankimit, parashkrimi apo shuarja e këtyre masave përcaktohen në ligjin për krijimin e UP-së përkatëse.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 19
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, të nxjerrë aktet nënligjore përkatëse në zbatim të neneve 9 pika 4 shkronja b dhe 13 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri që mbulon fushën e arsimit që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, të nxjerrë aktet nënligjore përkatëse në zbatim të nenit 10 pikat 2, 6, 7 e 8 dhe të nenit 11 pika 7 të këtij ligji.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6322, datë 5.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 172, datë 22.10.2009

**PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.9157, DATË 4.12.2003 “PËR PËRGJIMIN E
TELEKOMUNIKACIONEVE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9157, datë 4.12.2003 “Për përgjimin e telekomunikacioneve”, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 6 pika 1, fjalët “dhe të Ministrisë së Mbrojtjes” zëvendësohen me fjalët “të Ministrisë së Mbrojtjes, të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Drejtësisë”.

Neni 2

Në nenin 8, fjalët “ose Ministrit të Drejtësisë” zëvendësohen me fjalët “Ministrit të Drejtësisë ose Ministrit të Financave, si dhe çdo ministri, që ka në varësi shërbime informative/policore të krijuara me ligj”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6323, datë 5.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.10 173, datë 22.10.2009

**PËR MBROJTJEN E DËSHMITARËVE DHE TË BASHKËPUNËTORËVE TË
DREJTËSISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Objekti

Ky ligj rregullon masat e posaçme, të përkohshme dhe të jashtëzakonshme, mënyrën dhe procedurat e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, si dhe organizimin, funksionimin, kompetencat dhe marrëdhëniet ndërmjet organeve të ngarkuara për propozimin, vlerësimin, miratimin dhe zbatimin e programit të mbrojtjes.

Neni 2

Fusha e veprimit

Dispozitat e këtij ligji janë të zbatueshme në kuadër të procedimeve penale për krime të kryera me dashje, për të cilat ligji parashikon dënim me burgim jo më pak se 4 vjet, në minimum. Rrezikshmëria e këtyre krimeve dhe e autorëve të tyre duhet të jetë e tillë, që të justifikojë kryerjen e shpenzimeve të nevojshme për mbrojtjen e një ose të disa personave.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Programi i mbrojtjes” janë masat e posaçme, ndihmëse dhe të jashtëzakonshme, që zbaton Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të personave të mbrojtur, në kushtet e parashikuara nga ky ligj.

2. “Dëshmitar i drejtësisë” është personi, i cili, në cilësinë e dëshmitarit ose të personit të dëmtuar, bën deklarime a dëshmon për fakte e rrethana, që përbëjnë objekt prove në një procedim penal dhe që, për shkak të këtyre deklarimeve a dëshmive, ndodhet në gjendje rreziku.

3. “Bashkëpunëtor i drejtësisë” është personi, i cili vuan dënimin penal ose është i pandehur në një procedim penal për krime të kryera në bashkëpunim, që ndodhet në gjendje rreziku, për shkak të bashkëpunimit me drejtësinë, të deklarimeve apo dëshmive për fakte e rrethana, që përbëjnë objekt prove në të njëjtin procedim penal ose në një procedim të lidhur.

4. “Persona të lidhur” janë personat, të cilët ndodhen në gjendje rreziku, për shkak të lidhjeve të gjakut, të martesës, të bashkëjetesës së faktit ose marrëdhënieve të ngushta personale, që kanë me dëshmitarin ose me bashkëpunëtorin e drejtësisë.

5. “Persona të mbrojtur”, bashkërisht ose veçmas, janë dëshmitarët, bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe personat e lidhur me ta, sipas përcaktimeve të bëra në pikat 2, 3 e 4 të këtij neni.

6. “Gjendje rreziku” është gjendja aktuale, konkrete dhe serioze, për shkak të së cilës jeta e shëndeti janë në rrezik, si pasojë e dëshmimit të dëshmitarit apo të bashkëpunëtorit të drejtësisë në procesin penal, për veprat penale të parashikuara në këtë ligj.

KREU II

ORGANET PËRGJEGJËSE PËR MBROJTJEN E DËSHMITARËVE DHE TË BASHKËPUNËTORËVE TË DREJTËSISË

Neni 4

Organet përgjegjëse

Organe përgjegjëse për përgatitjen, vlerësimin, miratimin dhe zbatimin e programit të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë janë:

a) Komisioni për Vlerësimin e Programit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, më poshtë komisioni;

b) Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, më poshtë drejtoria.

Neni 5

Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë

1. Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, si strukturë e posaçme qendrore e Policisë së Shtetit, pranë Departamentit për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, është organi përgjegjës për përgatitjen, ndjekjen dhe zbatimin e programit të mbrojtjes. Kjo e shtrin veprimtarinë e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Struktura dhe organika e drejtorisë miratohen nga Ministri i Brendshëm.

3. Drejtoria ka buxhetin e vet, si njësi shpenzimi në buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Administrimi i pasurive dhe fondeve të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së drejtorisë, dokumentimi i shpenzimeve dhe kontrolli i veprimtarisë financiare të drejtorisë bëhen në mënyrë të tillë, që të mos lejojnë identifikimin e të dhënave me natyrë sekrete e operative.

4. Trajtimi dhe përfitimet e punonjësve të drejtorisë rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6 Detyrat e drejtorisë

Drejtoria ka këto detyra:

a) përgatit dhe dërgon për shqyrtim në komision propozimet e dërguara nga Prokurori i Përgjithshëm, për pranimin në programin e mbrojtjes;

b) kryen një vlerësim të kushteve fizike dhe psikologjike të personit të propozuar për t'u pranuar në programin e mbrojtjes dhe një vlerësim të gjithanshëm të gjendjes së rrezikut, me qëllim që komisioni të jetë sa më i informuar për përshtatshmërinë e personit me programin e mbrojtjes;

c) vendos zbatimin e masave të përkohshme të mbrojtjes, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga komisioni, në rastet dhe mënyrën e parashikuar në nenin 18 të këtij ligji;

ç) zbaton masat e posaçme dhe ndihmëse të mbrojtjes, që do të zbatohen për personin ose personat e pranuar në program, pas marrjes së vendimit të komisionit për pranimin në programin e mbrojtjes;

d) përgatit dhe nënshkruan marrëveshjen e mbrojtjes me personat e mbrojtur, sipas nenit 19 të këtij ligji;

dh) ndjek zbatimin e programit të mbrojtjes;

e) administron bazën e të dhënave, që lidhet me veprimtarinë e drejtorisë dhe ecurinë e programit të mbrojtjes dhe merr masa për t'i siguruar e administruar ato, në përputhje me shkallën e nevojshme të klasifikimit të informacionit, sipas dispozitave ligjore në fuqi;

ë) administron pasuritë dhe fondet në dispozicion të drejtorisë për ushtrimin e veprimtarisë dhe zbatimin e programit të mbrojtjes, përfshirë marrjen me qira të mjediseve të nevojshme për punë teknike e operative;

f) propozon dhe merr masa për bashkërendimin e punëve me institucione të tjera për zbatimin e programit të mbrojtjes ndaj personave të mbrojtur;

g) ndjek çështjet e bashkëpunimit me strukturat ndërkombëtare ose të shteteve të tjera në fushën e mbrojtjes;

gj) përgatit raporte periodike për veprimtarinë e zhvilluar dhe bën propozime për përmirësimin e legjislacionit, për zbatimin e programit të mbrojtjes ndaj personave të mbrojtur. Raportet e drejtorisë përmbajnë vetëm statistika. Asnjë dispozitë ligjore për të drejtën e informimit nuk e vë drejtorinë para detyrimit për t'u dhënë informacion, qoftë edhe në mënyrë të përmblëdhur e të reduktuar, institucioneve shtetërore, shtypit apo publikut. Raportet periodike përgatiten çdo gjashtë muaj dhe i vihen në dispozicion komisionit.

Neni 7 Kompetenca të veçanta të drejtorisë

1. Drejtoria, kur e sheh të nevojshme, në funksion të zbatimit të masave të mbrojtjes, u drejtohet, me një kërkesë të arsyetuar, me shkrim, institucioneve të tjera shtetërore:

a) për informacionin e nevojshëm;

b) për të mos u dhënë informacion enteve ose personave që, në kushte normale, kanë të drejtë ta marrin këtë informacion;

c) për t'i informuar, në çdo rast, kur persona ose ente të tjera bëjnë përpjekje të marrin informacion për personat e mbrojtur.

2. Drejtoria, në zbatim të programit të mbrojtjes, ka të drejtë të përdorë identitete të rreme dhe t'u kërkojë institucioneve të tjera shtetërore të ndihmojnë në krijimin e tyre:

a) për personat e mbrojtur;

b) për punonjësit e drejtorisë, që kryejnë detyra konkrete, në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga ky ligj.

3. Për efekt të përjashtimit nga përgjegjësia penale, personat që përdorin identitete të rreme, në zbatim të pikës 2 të këtij neni dhe funksionarët publikë, që ndihmojnë në krijimin e këtyre identiteteve, vlerësohen se kanë vepruar në ushtrim të një të drejte ose në zbatim të detyrës së ngarkuar nga ligji, sipas nenit 21 të Kodit Penal.

Neni 8

Emërimi, lirimi dhe përjashtimi nga policia i punonjësve të drejtorisë

1. Oficerët e policisë në drejtori përzgjidhen nga radhët e punonjësve të policisë, që plotësojnë kriteret për t'u emëruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në përputhje me ligjet e aktet nënligjore në fuqi.

2. Kandidatët për punonjës të drejtorisë i nënshtrohen verifikimit të personalitetit të tyre nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme.

3. Transferimi i oficerëve të policisë të drejtorisë në një detyrë tjetër në Policinë e Shtetit bëhet në përputhje me procedurën e parashikuar në ligjin nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, vetëm me pëlqimin paraprak, me shkrim, të oficerit.

4. Marrja e masave disiplinore për punonjësit e drejtorisë dhe ankimi ndaj tyre bëhet në bazë të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”.

Neni 9

Komisioni për Vlerësimin e Programit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë

1. Komisioni për Vlerësimin e Programit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë është organi përgjegjës që vlerëson dhe miraton propozimet e drejtorisë për:

- a) pranimin në programin e mbrojtjes;
- b) masat konkrete të mbrojtjes;
- c) ndërprerjen e programit;
- ç) përfundimin e këtij programi.

Komisioni ka kompetencë edhe shqyrtimin e ankesave të bëra në përputhje me nenin 26 të këtij ligji.

2. Komisioni kryesohet nga zëvendësministri i brendshëm, që mbulon çështjet e rendit publik dhe në përbërje të tij ka:

- a) një gjyqtar të propozuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në detyrën e zëvendëskryetarit;
- b) një prokuror të propozuar nga Prokurori i Përgjithshëm në detyrën e anëtarit;
- c) një oficer të policisë gjyqësore të propozuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit në detyrën e anëtarit;
- ç) drejtori i drejtorisë në detyrën e anëtarit.

3. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit caktojnë edhe nga një anëtar zëvendësues, të cilët do të marrin pjesë në mbledhjet e komisionit, kur ekziston një arsye, që i ndalon anëtarët respektivë të marrin pjesë në mbledhjet e komisionit.

4. Anëtarët e komisionit caktohen në detyrë për një afat trevjeçar, me të drejtë riemërimi. Anëtarësia në komision përfundon përpara afatit:

- a) kur anëtari nuk ushtron më funksion në institucionin që e ka propozuar, ose për shkak të të cilit është emëruar;
- b) me kërkesën e vet, të shoqëruar me arsye të bazuara;
- c) për shkak të mungesës së pajustificuar në dy mbledhje radhazi të komisionit;
- ç) për shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe të rregullave të funksionimit të komisionit.

5. Vendimi për përfundimin e qëndrimit në detyrë të anëtarit të komisionit merret nga organi përgjegjës për emërimin e tyre. Në rastin e shkronjës “b” të pikës 4 të këtij neni, vendimi merret me kërkesë të vetë anëtarit, ndërsa në rastin e shkronjave “c” e “ç”, me kërkesë të komisionit.

6. Gjyqtari, prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore, anëtarë të komisionit, nuk mund të marrin pjesë në diskutim dhe në vendimmarrje, kur vihen në dijeni se propozimi për pranim në program ka lidhje me procedime penale apo veprimtari, që hetohen ose gjykohen prej tyre. Ky ndalim vlen edhe kur ka konflikt interesash ose dyshime për njëanshmëri, të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe në dispozitat e tjera ligjore në fuqi. Në raste të tilla, ata zëvendësohen nga anëtarët zëvendësues.

KREU III
PROGRAMI PËR MBROJTJEN E DËSHMITARËVE DHE TË BASHKËPUNËTORËVE TË
DREJTËSISË

Neni 10

Kushtet e përgjithshme për zbatimin e programit të mbrojtjes

1. Kur zbatimi i masave të zakonshme të mbrojtjes për dëshmitarin ose bashkëpunëtorin e drejtësisë nuk është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm, zbatohet programi i mbrojtjes, sipas këtij ligji, nëse ai pranon të bashkëpunojë me vullnet të lirë me prokurorinë dhe gjykatën dhe, nëpërmjet deklarimeve dhe/ose dëshmisë së vet të plotë, të bërë pa kushte dhe rezerva, të japë të dhëna të bazuara, që përbëjnë prova vendimtare për zbulimin, hetimin dhe gjykimin e krimeve dhe të autorëve të tyre.

2. Zbatimi i programit të mbrojtjes për dëshmitarin ose bashkëpunëtorin e drejtësisë vendoset vetëm nëse ai ndodhet në gjendje rreziku, është i përshtatshëm për t'u përfshirë në program dhe, me vullnetin e vet të lirë, pranon e merr pjesë aktivisht në zbatimin e tij.

3. Përshtatshmëria ka të bëjë me kushtet psikologjike, sociale dhe fizike të dëshmitarit ose të bashkëpunëtorit, të cilat duhet të jenë të tilla, që të krijojnë besim se ai do të zbatojë rregullat e programit të mbrojtjes dhe nuk do të vërë në rrezik jetën e shëndetin e vet, jetën e shëndetin e personave të tjerë. Nëse ka mundësi, ndaj tij merret masa e ndryshimit të vendbanimit, si dhe e programit në tërësi.

4. Në rastin e dëshmitarit ose të bashkëpunëtorit të mitur, përveç rrethanave të mësipërme, duhet të vlerësohen edhe pasojat e pranimin në program për zhvillimin e tij psiko-social.

5. Në varësi të rrethanave konkrete, bashkë me dëshmitarin ose bashkëpunëtorin e drejtësisë mund të përfshihen në programin e mbrojtjes edhe personat e lidhur me të. Edhe në këtë rast zbatohen rregullat që parashikohen në pikat 1 e 2 të këtij neni.

6. Programi i mbrojtjes nuk ka për qëllim të sjellë përmirësimin e gjendjes ekonomike të personit të mbrojtur. Drejtoria, komisioni dhe asnjë institucion tjetër shtetëror nuk përgjigjen për detyrimet financiare, që personat e mbrojtur kanë në çastin e pranimin në programin e mbrojtjes.

Neni 11

Kohëzgjatja e programit të mbrojtjes

1. Programi i mbrojtjes, si rregull, zbatohet për një afat të pacaktuar dhe mund të shtrihet në të gjitha fazat e procedimit penal, si dhe pas përfundimit të tyre.

2. Kohëzgjatja e zbatimit të programit të mbrojtjes varet nga ekzistenca e gjendjes së rrezikut, përshtatshmëria e personit të mbrojtur, në raport me masën e posaçme të mbrojtjes që zbatohet, si dhe nga zbatimi, prej personit të mbrojtur, i detyrimeve të parashikuara në marrëveshjen e mbrojtjes.

Neni 12

Masat e mbrojtjes

Në kuadër të programeve të mbrojtjes, një ose disa nga masat e mbrojtjes që zbatohen për personat e mbrojtur janë:

- a) ndryshimi i identitetit;
- b) ndryshimi i vendbanimit;
- c) dhënia e dokumenteve të rreme;
- ç) mbrojtja e përkohshme e identitetit, e të dhënave dhe e dokumenteve;
- d) dhënia e dëshmisë me një identitet tjetër dhe administrimi me mjete të veçanta për deformimin e zërit a të pamjes së tij dhe forma të tjera të caktuara sipas ligjit, në përputhje me nenin 361/a të Kodit të Procedurës Penale;
- dh) mbrojtja fizike dhe teknike në vendin ku qëndron personi, si dhe gjatë lëvizjeve të tij;

- e) rehabilitimi social;
- ë) dhënia e ndihmës financiare;
- f) rikualifikimi profesional;
- g) dhënia e këshillave dhe e ndihmës së specializuar ligjore;
- gj) çdo masë tjetër, e cila vlerësohet dhe miratohet si e nevojshme në përputhje me këtë ligj.

Neni 13

Përgjegjësia për zbatimin e programit të mbrojtjes

1. Drejtoria përgjigjet për përgatitjen, bashkërendimin e punëve dhe ndjekjen e zbatimit të programit të mbrojtjes.
2. Drejtoria bashkëpunon me ministritë dhe institucionet e tjera qendrore për çështje që kanë të bëjnë me ndjekjen dhe zbatimin e programit të mbrojtjes.
3. Organet e përmendura në pikën 2 të këtij neni bashkërendojnë punën e tyre me drejtorinë, u përgjigjen kërkesave të kësaj drejtorie dhe të prokurorit, si dhe njoftojnë për çështje e rrethana, që kanë të bëjnë me zbatimin e programit të mbrojtjes.

Neni 14

Administrimi i akteve, i dokumentacionit dhe i informacionit

1. Aktet, dokumentacioni dhe çdo informacion, që lidhet me propozimin, miratimin dhe zbatimin e programit të mbrojtjes, vlerësohen “Informacion i klasifikuar” dhe mbahen e administrohen nga Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.
2. Aktet, dokumentacioni, të dhënat, si dhe çdo informacion, që zotërojnë dhe administrojnë ministritë e institucionet e tjera qendrore, për programin e mbrojtjes, vlerësohen “Informacion i klasifikuar”.

KREU IV

PROCEDURAT PËR MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PROGRAMIT TË MBROJTJES

Neni 15

Propozimi për pranim në programin e mbrojtjes

1. Të drejtën për të propozuar pranimin e një ose të disa personave në programin e mbrojtjes e ka Prokurori i Përgjithshëm.
2. Propozimi i Prokurorit të Përgjithshëm për pranimin e një ose të disa personave në programin e mbrojtjes përmban, domosdoshmërisht, të dhënat e mëposhtme:
 - a) të dhëna personale të personit, që propozohet të mbrohet;
 - b) shpjegime për rëndësinë e deklarimeve të bëra apo që mund të sigurohen nga dëshmitari ose bashkëpunëtori i drejtësisë, si dhe arsyet përse dhënia e lirë e dëshmimeve nuk mund të sigurohet në mënyrë tjetër;
 - c) rrethanat në të cilat ose për shkak të të cilave dëshmitari a bashkëpunëtori i drejtësisë ka marrë dijeni për të dhënat dhe deklarimet, që ka bërë ose që mund të sigurohen prej tij;
 - ç) të dhëna dhe shpjegime të tjera, që shërbejnë për të motivuar e mbështetur vlerësimin për gjendjen e rrezikut, ku ndodhet apo parashikohet të ndodhet personi, që propozohet të mbrohet;
 - d) informacione për gjendjen financiare të dëshmitarit;
 - dh) informacione të tjera, sipas vlerësimit të prokurorit.
3. Në rastin e bashkëpunëtorit të drejtësisë, propozimi shoqërohet me përshkrimin e kushteve të bashkëpunimit me drejtësinë, të cilat do të bëhen pjesë e marrëveshjes së mbrojtjes, sipas nenit 37/a të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 16

Shqyrtimi i propozimit për pranimin në programin e mbrojtjes

1. Propozimi i Prokurorit të Përgjithshëm për pranimin e një ose të disa personave në programin e mbrojtjes, së bashku me informacionin bazë, sipas nenit 13 të këtij ligji, depozitohen pranë Drejtorisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe të Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, e cila kryen edhe funksionet e sekretarisë teknike. Kjo drejtori ia përcjell praktikën për shqyrtim kryetarit të komisionit jo më vonë se 24 orë nga data e depozitimit të saj.

2. Prokurori i Përgjithshëm, kur është rasti, së bashku me propozimin, i paraqet drejtorisë një kërkesë, ku parashtrohen edhe arsyet, sipas së cilës kjo drejtori, në përputhje me rrethanat konkrete, të zbatojë masa të përkohshme mbrojtjeje, derisa të përfundojë shqyrtimi i propozimit të tij nga komisioni.

3. Me marrjen e propozimit, kryetari i komisionit ngarkon drejtorinë të kryejë vlerësimin e kushteve fizike dhe psikologjike të personit të propozuar për t'u pranuar në programin e mbrojtjes, vlerësimin e gjithanshëm të gjendjes së rrezikut, si dhe përshtatshmërinë e personit me programin. Për vlerësimin e gjendjes së rrezikut, drejtoria mund t'i kërkojë dëshmitarit, bashkëpunëtorit të drejtësisë ose personave të lidhur me ta informacion për çdo shkelje të mëparshme të ligjit të kryera prej tij, pavarësisht nëse është dënuar për ato ose jo. Në rastet kur bëhen deklarime për vepra penale të kryera nga dëshmitari, bashkëpunëtori i drejtësisë ose personat e lidhur me ta, drejtoria njofton menjëherë Prokurorin e Përgjithshëm për të riparë kërkesën vetëm për qëllimin e parashikuar në këtë pikë.

Neni 17

Vendimarrja e komisionit

1. Mbledhjet e komisionit thirren nga kryetari brenda 5 ditëve nga dorëzimi në drejtori i propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm. Në raste të veçanta dhe urgjente ky komision mblidhet menjëherë.

2. Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme, kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij. Vendimet e tij janë të vlefshme, kur miratohen nga tre anëtarë të pranishëm në mbledhje.

3. Komisioni merr vendim jo më vonë se 10 ditë nga mbledhja e parë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 15 ditë nga data e depozitimit në drejtori të propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të dokumentacionit përkatës.

4. Rregullat dhe procedurat e parashikuara në këtë nen zbatohen edhe në rastet e ndërprerjes dhe të përfundimit të programit të mbrojtjes.

Neni 18

Masa të përkohshme të mbrojtjes

1. Në raste të veçanta dhe urgjente, drejtoria, me kërkesën e prokurorit që procedon, vendos zbatimin e menjëhershëm të masave të përkohshme të mbrojtjes. Për këtë qëllim, drejtoria dhe personi i mbrojtur nënshkruajnë një marrëveshje të përkohshme mbrojtjeje. Prokurori i Përgjithshëm duhet të paraqesë propozimin për pranimin e personit në programin e mbrojtjes brenda 30 ditëve nga data e fillimit të zbatimit të masave të përkohshme.

2. Masat e përkohshme të mbrojtjes vendosen në përputhje me gjendjen e rrezikut, në forma të tilla, që garantojnë, përkohësisht dhe paraprakisht, nivelin e domosdoshëm të mbrojtjes.

Neni 19

Marrëveshja me personin e mbrojtur

1. Në një kohë sa më të shkurtër dhe në çdo rast, jo më vonë se 10 ditë nga data e miratimit të pranimin në programin e mbrojtjes, drejtoria përgatit marrëveshjen për zbatimin e programit (marrëveshjen e mbrojtjes) dhe merr masa për bisedimin dhe nënshkrimin e saj me dëshmitarin, bashkëpunëtorin e drejtësisë dhe personat e tjerë të mbrojtur.

2. Përpara se të nënshkruhet marrëveshja, bashkëpunëtori i drejtësisë detyrohet të informojë drejtorinë me hollësi për llojet dhe masën e pasurive të zotëruara prej tij. Nëse ndonjë nga pasuritë, që zotërohen nga bashkëpunëtori i drejtësisë, është produkt i veprave penale, e ardhur ose përfitim nga produktet e veprës penale, apo pasuritë, me të cilat janë përzier këto produkte, atëherë personi duhet ta deklarojë këtë fakt. Në rastet kur bëhet një deklaram i tillë, drejtoria njofton menjëherë Prokurorin e Përgjithshëm.

3. Drejtoria vë në dijeni Prokurorin e Përgjithshëm për nënshkrimin e marrëveshjes së mbrojtjes. Përmbajtja e marrëveshjes, hollësitë për vendndodhjen e personit apo të identitetit të tij të ri nuk i bëhen të ditura Prokurorit të Përgjithshëm ose prokurorit që procedon, kurse vendndodhja dhe identiteti i tij i ri nuk duhet t'i bëhen të ditur as komisionit.

4. Përgjegjësitë dhe efektet e programit të mbrojtjes për drejtorinë dhe personin e mbrojtur fillojnë në kohën dhe mënyrën e parashikuar në marrëveshje.

5. Në rastin kur personi i mbrojtur është i mitur ose është madhor, por i është hequr a kufizuar zotësia për të vepruar, në përputhje me parimet e interesit më të lartë të tij dhe ato të zotësisë për të vepruar, atij i merret mendimi për pranimin në program dhe për përmbajtjen e marrëveshjes. Në këto raste, dhënia përfundimtare e pëlqimit dhe nënshkrimi i marrëveshjes së mbrojtjes bëhen nga prindi ose kujdestari i tij.

6. Marrëveshja e mbrojtjes nuk është marrëdhënie detyrimi, në kuptim të Kodit Civil. Personi i mbrojtur ose trashëgimtarët e tij nuk mund të kërkojnë në gjykatë ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje dhe as dëmshpërblim, në rastet kur marrëveshja nuk është ekzekutuar apo kur ai pretendon se i ka ardhur ndonjë dëm.

Neni 20

Përmbajtja e marrëveshjes

1. Në marrëveshjen e mbrojtjes parashikohen, detyrimisht, këto çështje:
 - a) detyrimet e personave të mbrojtur;
 - b) masat e posaçme dhe ndihmëse, që do të merren nga drejtoria për të ofruar mbrojtjen e duhur, sipas nivelit dhe rrethanave të rrezikut;
 - c) rastet dhe rrethanat e ndryshimit dhe të ndërprerjes së programit të mbrojtjes;
 - ç) rastet e pranimit vullnetar të programit të mbrojtjes nga personi i mbrojtur;
 - d) kushtet e bashkëpunimit me drejtësinë, në rastin e bashkëpunëtorëve të drejtësisë.
2. Marrëveshja e mbrojtjes parashikon, gjithashtu, rregullimin më të hollësishëm të përmbushjes, nga personat e mbrojtur, të kushteve dhe detyrimeve, si më poshtë:
 - a) të pranojë kushtet dhe udhëzimet e përcaktuara për programin e mbrojtjes dhe të bashkëpunojë në mënyrë aktive për zbatimin e tyre;
 - b) të mbajë parasysh natyrën e informacionit të klasifikuar dhe, në çfarëdo rrethane, të mos bëjë të ditur asnjë të dhënë për programin e mbrojtjes dhe të dhëna të tjera të lidhura me të, duke u paralajmëruar për përgjegjësi penale, sipas nenit 295/a të Kodit Penal, në rast të shkeljes së detyrimit për të ruajtur sekretin, që lidhet me programin e mbrojtjes, edhe pas përfundimit të tij;
 - c) të mënjanojë çdo veprim ose mosveprim, që mund të rrezikojë zbatimin e programit të mbrojtjes apo që mund të sjellë, si pasojë, një gjendje tjetër rreziku për personin e mbrojtur;
 - ç) të informojë menjëherë drejtorinë për çështje që kërkohen prej saj, ose për ngjarje apo ndryshime të rrethanave të jetës a veprimtarive të tij personale, si dhe për kontaktet e marrëdhëniet me të tretë, që mund të rrezikojnë zbatimin dhe garancitë e ofruara nga programi i mbrojtjes;
 - d) të pranojë, pa nevojën e një vendimi gjyqësor të posaçëm, nëse është e domosdoshme për qëllimet e mbrojtjes apo të procedimit penal, përdorimin në mjediset e veta të mjeteve teknike të ruajtjes, vëzhgimit dhe regjistrimit pamor dhe/ose zanor;
 - dh) detyrime të tjera që drejtoria i çmon të domosdoshme, në varësi të natyrës dhe rrethanave të rastit konkret;
 - e) detyrimet për prindin apo kujdestarin, në rastin kur personi i mbrojtur është i mitur, ose kur atij i është hequr a kufizuar zotësia për të vepruar.

Neni 21

Përgjashtimi i punonjësve të drejtorisë nga përgjegjësia civile

Ndaj punonjësit të drejtorisë nuk mund të ngrihet padi civile nga personat e pranuar në programin e mbrojtjes për veprimet dhe/ose mosveprimet e kryera në mirëbesim gjatë ushtrimit të një detyre të ngarkuar nga ky ligj.

Neni 22

Masa të jashtëzakonshme mbrojtjeje

1. Policia e Shtetit, institucionet e paraburgimit ose institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, sipas nivelit të gjendjes së rrezikut për dëshmitarët, bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe personat e lidhur me ta, mund të urdhërojnë dhe zbatojnë masa mbrojtjeje të jashtëzakonshme, sipas përcaktimeve të parashikuara në këtë ligj apo në ligje ose akte të tjera, që rregullojnë veprimtarinë e tyre. Këto masa, jo më vonë se 24 orë nga marrja e tyre, i njoftohen prokurorit që procedon.

2. Masat e jashtëzakonshme, me pëlqimin e prokurorit që procedon, mund të zgjaten derisa të mënjanohet rreziku, që ka motivuar marrjen e tyre ose deri në marrjen e vendimit përkatës nga komisioni.

Neni 23

Ndërprerja e programit të mbrojtjes

1. Programi i mbrojtjes mund të ndërpritet nga komisioni në këto raste:

a) nëse gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjes penale vërtetohet se dëshmitari ose bashkëpunëtori i drejtësisë bën deklaratime a dëshmi të rreme apo, për çfarëdo arsye, nuk i jep deklaratimet ose dëshmitë, për të cilat u lejua pranimi në programin e mbrojtjes;

b) nëse personi i mbrojtur kryen një vepër penale me dashje;

c) nëse pas fillimit të zbatimit të programit të mbrojtjes sigurohen të dhëna të arsyeshme dhe të bazuara për përfshirjen e personit të mbrojtur në veprimtari kriminale, të padeklaruara prej tij;

ç) nëse dëshmitari, bashkëpunëtori i drejtësisë ose persona të tjerë të mbrojtur nuk respektojnë detyrimet e përmendura në marrëveshjen e mbrojtjes dhe/ose kushtet e bashkëpunimit me drejtësinë;

d) nëse një autoritet i një shteti tjetër kërkon mbarimin e programit të mbrojtjes, të zbatuar në territorin e atij shteti.

2. Gjatë shqyrtimit të rrethanave të ndërprerjes së programit të mbrojtjes, komisioni vihet në dijeni vetëm për arsyet e ndërprerjes së programit.

Neni 24

Përfundimi i programit të mbrojtjes

1. Programi i mbrojtjes përfundon në rastet e mëposhtme:

a) nëse vlerësohet se nuk ekziston më gjendja e rrezikut, që motivon zbatimin e programit të mbrojtjes;

b) nëse personi i mbrojtur ka vdekur;

c) me kërkesë, me shkrim, të personit të mbrojtur ose të kujdestarit të tij.

2. Pas përfundimit të programit të mbrojtjes, personi i mbrojtur mund të zgjedhë mbajtjen e identitetit të ri, nëse i është dhënë një i tillë, ose marrjen përsëri të identitetit të tij të vërtetë.

3. Nëse personi, ndaj të cilit zbatohet programi i mbrojtjes, vritet ose dëmtohet fizikisht, në masën që bëhet i paafte për punë, për shkak të dështimit të masave të zbatuara të mbrojtjes, me propozimin e drejtorisë, komisioni mund t'i caktojë personit ose anëtarëve të familjes, që kanë qenë në ngarkim të tij, ndihmë financiare të posaçme.

Neni 25
**Njoftime për ndërprerjen ose përfundimin
e programit të mbrojtjes**

1. Drejtoria njofton menjëherë, me shkrim, Prokurorin e Përgjithshëm për rrethanat e përmendura në nenet 23 e 24 të këtij ligji.

2. Në rastin e kërkesës për përfundimin e programit të mbrojtjes ose kur ka vdekur personi i mbrojtur, programi i mbrojtjes përfundon menjëherë për kërkuesin a personin e vdekur, por ai mund të vazhdojë, në varësi të rrethanave, për personat e tjerë të mbrojtur, të përfshirë në të.

Neni 26
Procedura e ankimit

1. Personi i mbrojtur ka të drejtë të ankohet para komisionit dhe të kërkojë ndryshimin ose plotësimin e masave të zgjedhura, që duhet të zbatohen ndaj tij nga drejtoria, duke parashtruar shkaqet. Afati për të paraqitur ankimin është 5 ditë, duke filluar nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit të drejtorisë. Ankimi nuk pezullon zbatimin e masës së zgjedhur. Vendimi i komisionit është përfundimtar.

2. Gjatë shqyrtimit të ankimit, sipas pikës 1 të këtij neni, komisioni nuk vihet në dijeni të hollësive që zbulojnë identitetin dhe vendndodhjen e deriatëhershme të personit që është në programin e mbrojtjes.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 27
Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Bashkëpunimi ndërkombëtar realizohet në bazë të të drejtave dhe detyrimeve, që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, ose nëpërmjet marrëveshjeve, për raste konkrete, të lidhura nga drejtori i drejtorisë me njësi të ngjashme në vende të tjera.

2. Marrëveshjet për programe mbrojtjeje konkrete mund të parashikojnë zbatimin e ndërsjellë të programit të mbrojtjes, përfshirë ndryshimin e vendbanimit dhe qëndrimin e personave të mbrojtur në territoret përkatëse të palëve.

3. Marrëveshjet për rastet konkrete përbëjnë “Informacion të klasifikuar” dhe për nënshkrimin e tyre nuk zbatohen rregullat e përgjithshme si në rastin e marrëveshjeve ndërkombëtare, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 28
Aktet nënligjore

Brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, miratohen aktet nënligjore në zbatim të tij, si më poshtë:

1. Vendim i Këshillit të Ministrave për trajtimin dhe përfitimet e punonjësve të Drejtorisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 5 të këtij ligji.

2. Udhëzim i përbashkët i Ministrit të Brendshëm dhe Prokurorit të Përgjithshëm për:

a) rregullat dhe kriteret e hollësishme për çështjet e parashikuara në pikat 1, 2 e 3 të nenit 10 të këtij ligji;

b) rregullat e hollësishme për detyrat, përgjegjësitë, format dhe procedurat e bashkërendimit e të informimit, ndërmjet institucioneve, në zbatim të nenit 13 të këtij ligji;

c) kriteret dhe procedurat për ruajtjen, administrimin dhe klasifikimin e informacionit për programin e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, në zbatim të pikës 1 të nenit 14 të këtij ligji;

ç) rregullat e hollësishme për rastet, procedurat dhe mënyrat e zbatimit të masave të mbrojtjes, në zbatim të neneve 15, 16 e 18 të këtij ligji.

3. Udhëzim i përbashkët i Ministrit të Brendshëm dhe i Ministrit të Financave për:

a) administrimin e pasurive dhe të fondeve të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së drejtorisë, dokumentimin e shpenzimeve dhe kontrollin e veprimtarisë financiare të drejtorisë, në zbatim të pikës 3 të nenit 5 të këtij ligji;

b) mënyrën e caktimit të ndihmës financiare dhe masën e saj, në zbatim të nenit 12 të këtij ligji.

4. Rregullore e brendshme e drejtorisë për:

a) rregullat me karakter teknik dhe operativ për kushtet, metodikat dhe procedurat e verifikimit, të përgatitjes dhe zbatimit të programit të mbrojtjes, për mënyrat, format e mjetet e komunikimit, si dhe për administrimin e akteve e të informacionit, që lidhet me veprimtarinë e vet, në zbatim të nenit 6 të këtij ligji;

b) rregullat dhe kriteret e hollësishme për përmbajtjen, kuptimin, përshtatshmërinë, mënyrën dhe procedurat e caktimit dhe të shkallëzimit të masave, që përbëjnë programin e mbrojtjes;

c) rregullat e hollësishme për procedurat e shprehjes së vullnetit, bisedimit dhe nënshkrimit, për formën dhe përmbajtjen, si dhe për ndjekjen e zbatimit të kushteve të marrëveshjes së mbrojtjes, në zbatim të neneve 19 e 20 të këtij ligji.

5. Rregullore e brendshme e komisionit për rregullat e hollësishme për kriteret dhe procedurat e punës, për thirrjen dhe pjesëmarrjen në mbledhjet e tij, mungesën dhe pamundësinë e caktimit dhe të kryerjes së kësaj detyre.

6. Udhëzimet e titullarëve të institucioneve për depozitimin, mbajtjen dhe administrimin e informacionit për programin e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, në zbatim të pikës 2 të nenit 14 të këtij ligji.

Neni 29 Shfuqizime

Ligji nr.9205, datë 15.3.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, shfuqizohet.

Neni 30 Dispozita kalimtare

1. Mandati i anëtarëve të komisionit, i filluar në përputhje me ligjin nr.9205, datë 15.3.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, do të vazhdojë deri në përfundim të mandatit të tyre.

2. Deri në miratimin e akteve nënligjore, sipas nenit 28 të këtij ligji, zbatohen aktet nënligjore, të miratuara në zbatim të ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 31 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6324, datë 5.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

VENDIM
Nr.6, datë 5.11.2009

**PËR ZGJEDHJEN E DY ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE
TELEVIZIONIT**

Në bazë të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës dhe në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zgjidhjen në detyrën e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT);
 1. Zonja Suela Mustë zgjidhet anëtare e KKRT-së në vend të zonjës Mesila Doda.
 2. Zonja Endira Bushati zgjidhet anëtare e KKRT-së në vend të zotit Artan Zeneli.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.7, datë 5.11.2009

**PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE
TELEVIZIONIT**

Në bazë të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës dhe në mbështetje të pikës 5 të nenit 9 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

1. Zonja Endira Bushati zgjidhet në detyrën e Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT).
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.8, datë 5.11.2009

**PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË ANËTARIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS
DHE TELEVISIONIT, ZOTIT DETAR HYSI**

Në bazë të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të nenit 15 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 45 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, si dhe të nenit 115 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Detar Hysi lirohet nga detyra e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT).

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.29, datë 21.10.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Piloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 27.11.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 22/8 Akti që i përket:

KËRKUES: NJË GRUP PREJ 30 DEPUTETËSH TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga avokat Vangjel Kosta, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga z.Lulzim Lelçaj, me autorizim.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

ZAMIR PODA, përfaqësuar nga avokat Artan Hoxha, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: 1. Interpretimi i pikës 1 të nenit 78 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit të publikuar të Kuvendit të Shqipërisë, nr. 190, datë 16.06.2008 “Për mosdhënien e pëlqimit për emërimin e z. Zamir Poda si anëtar i Gjykatës së Lartë”.

3. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr. 190, datë 16.06.2008 “Për mosdhënien e pëlqimit për emërimin e z. Zamir Poda si anëtar i Gjykatës së Lartë” deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, pika 2, 3; 78 pika 1; 124, pika 1; 131, germa “ç”; 134, pika 1, germa “c” dhe 136 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Vitore Tusha; përfaqësuesin e kërkuarit që kërkonte pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e Kuvendit, që kërkonte rrëzimin e kërkesës; përfaqësuesin e subjektit të interesuar Zamir Poda që iu bashkua kërkesës së kërkuarit dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me dekretin nr. 5720, datë 12.05.2008, ka emëruar z. Zamir Poda anëtar të Gjykatës së Lartë. Dekreti i është dërguar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (Kuvendit) për dhënien e pëlqimit, në mbështetje të nenit 136, pika 1 të Kushtetutës.

Kuvendi zhvilloi procesin e votimit më datë 16.06.2008 sipas nenit 60, pika 1 dhe 3 të Rregullores së Kuvendit. Procesi i votimit u drejtua nga Sekretariati i Kuvendit për Procedurat dhe Votimet, i përbërë nga 3 deputetë, njëri prej të cilëve kryetar dhe dy të tjerët anëtarë.

Në përfundim të procesit të votimit, pasi u numëruan fletët e votimit, rezultoi se pro kandidaturës së Zamir Podës ishin shprehur 65 deputetë, kundër 62 deputetë, 1 kishte abstenuar dhe 2 fletë votimi ishin të pavlefshme. Në përfundim të kësaj procedure, Kryetari i Sekretariatit ka deklaruar se, në përputhje me kërkesat e pikës 1 të nenit 55 të Rregullores, shumica e deputetëve kishte votuar pro kandidaturës së Zamir Podës për anëtar të Gjykatës së Lartë dhe për rrjedhojë, Kuvendi jepte pëlqimin që Z. Poda të ishte anëtar i Gjykatës së Lartë.

Pas përfundimit të seancës, Kryetari i Sekretariatit për Procedurat dhe Votimet ka deklaruar se “Kandidatura e z. Poda ishte rrëzuar, pasi kishte marrë 65 vota pro, ndërkohë që duhej të kishte marrë 66 vota pro, pra një votë më shumë se gjysma e deputetëve që ishin të pranishëm në seancën e votimit”.

Vendimi i Kuvendit nr. 190, datë 16.06.2008 “Për mosdhënien e pëlqimit të Kuvendit për emërimin e z. Zamir Poda si anëtar i Gjykatës së Lartë” është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 90, datë 17.06.2008.

2. Një grup prej jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit (Kërkuar), në cilësinë e subjektit të parashikuar nga neni 134, pika 1, shkronja “c” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetutës), ka paraqitur përpara Gjykatës Kushtetuese kërkesën me objekt:

2.1. Interpretimin përfundimtar të nenit 78, pika 1 të Kushtetutës për shumicën e kërkuar për marrjen e vendimeve nga Kuvendi i Shqipërisë, përfshirë dhe dhënien ose jo të pëlqimit për dekretet e Presidentit dhe interpretimin e nenit 55, pika 1 të Rregullores së Kuvendit.

Lidhur me këtë kërkesë, kërkuar ka paraqitur argumentet si vijojnë:

- Interpretimi i dispozitës kushtetuese është i nevojshëm për faktin se Rregullorja e Kuvendit, në nenin 55 nuk ka përcaktuar si llogaritet “shumica e votave” në rastin kur votohet sipas nenit 78, pika 1 të Kushtetutës dhe se Kuvendi, gjatë vendimmarrjes së tij rast pas rasti, ka bërë interpretime të ndryshme të kësaj dispozite të Kushtetutës.

- Kuptimi dhe interpretimi i togfjalëshit “shumicë votash”, sipas kërkuarit, ka vetëm kuptimin e “shumicës së thjeshtë”. Për t’u dalluar nga “shumica e cilësuar”, “shumica e thjeshtë” nuk llogaritet as “mbi tërë anëtarët” e as “mbi tërë pjesëmarrësit” në votime (raste që hyjnë tek shumica e cilësuar), por vetëm mbi votat e vlefshme. Vota e pavlefshme është e vesuar dhe si e tillë, ajo nuk mund të sjellë asnjë lloj pasoje juridike, prandaj nuk duhet llogaritur.

2.2. Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të botuar të Kuvendit nr. 190, datë 16.06.2008 “Për mosdhënien e pëlqimit për emërimin e z. Zamir Poda si anëtar i Gjykatës së Lartë”.

Lidhur me këtë kërkesë, kërkuesi argumenton:

- Publikimi i vendimit, duke shtrembëruar vullnetin e Kuvendit për dekretin e Presidentit, ka krijuar konflikt kompetencash midis Kuvendit të Shqipërisë dhe Kryetares së tij. Deputetët e Kuvendit nuk mund të pengohen të kundërshtojnë shtrembërimet që i bëhen vullnetit të Kuvendit si përfaqësues i pushtetit legjislativ në shprehjen dhe publikimin e këtij vullneti.

- Zotit Poda i është mohuar një e drejtë e fituar nëpërmjet votimit dhe shpalljes së vendimit sipas rregullave të parashikuara në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit. Dekreti i Presidentit, mbas dhënies së pëlqimit nga Kuvendi, në seancën e datës 16.06.2008, i ka dhënë të drejtën zotit Poda për të filluar dhe ushtruar detyrën si anëtar i Gjykatës së Lartë. Vendimi i publikuar i Kuvendit është shkelje e hapur e parimit të shtetit të së drejtës.

- Vendimi i Kuvendit është antikushtetues edhe nga pikëpamja procedurale për faktin, se Kuvendi vendos në seancë plenare dhe Sekretariati, në cilësinë e Komisionit të Votimit, deklaronte dhënien e pëlqimit. Vendimi është marrë në kundërshtim me nenet 74, 78 dhe 79 të Kushtetutës dhe nenit 57, pika 4, nenit 61, pika 2 të Rregullores së Kuvendit. Për rrjedhojë, “vendimi i dytë” i Kuvendit është absolutisht i pavlefshëm dhe nuk sjell asnjë pasojë juridike.

2.3. Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.190, datë 16.06.2008 të Kuvendit deri në dhënien e vendimit përfundimtar

3. Përfaqësuesi i Kuvendit ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke parashtruar se:

- Mbështetur në nenet 39 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, Presidenti i Republikës dhe shtetasi Zamir Poda nuk legjitimohen si subjekte të interesuara në këtë gjykim kushtetues, pasi në gjykime të karakterit abstrakt, si palë e interesuar, thirret organi që ka zbatuar normën objekt shqyrtimi.

- Neni 78, pika 1 kërkon që ligjet, vendimet, deklaratat dhe rezolutat të miratohen kur votojnë “pro” shumica e deputetëve të pranishëm dhe në asnjë rast, shumica e deputetëve që u konsiderohet vota e vlefshme. Kuorumi apo prania e deputetëve në votim shërben për të përcaktuar se sa është numri i anëtarëve të pranishëm në seancë plenare dhe sa do të marrin pjesë në një votim të caktuar.

- Interpretimi i një neni të Rregullores së Kuvendit nuk mund të jetë objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese, pasi rregullorja nuk është ligj kushtetues, por një akt që rregullon funksionimin e Kuvendit të Shqipërisë.

- Kërkesa për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese pasi kërkuesi, ndonëse proceduralisht ka barrën e të provuarit, nuk argumentojnë nëse ky vendim i Kuvendit është akt normativ. Gjithashtu, vendimi nuk krijon asnjë konflikt kompetence me ndonjë organ tjetër të pushtetit qendror apo vendor, çka do ta bënte të nevojshëm për t’ia nënshtruar kontrollit kushtetues sipas kërkesave të nenit 131/ç të Kushtetutës.

- Kërkesa për pezullim nuk është e bazuar në ligj, pasi ky vendim i Kuvendit nuk është akt normativ që imponon sjellje të përgjithshme të ndonjë institucioni apo organi shtetëror. Për rrjedhojë, ai nuk sjell ndonjë pasojë juridike për interesat shtetërore shoqërore apo të individëve.

4. Përfaqësuesi i subjektit të interesuar Zamir Poda, i bashkohet kërkesës së kërkuetit, për pranimin sipas objektit, duke parashtruar se:

- Termi “shumicë votash”, i parashikuar nga neni 78/1 i Kushtetutës duhet kuptuar si shumicë relative, ku mjafton që të ketë më shumë vota “pro” sesa “kundër” për të pasur një vendim të Kuvendit dhe në çdo rast, “shumica” nuk duhet lidhur me kuorumin e pjesëmarrjes;

- Botimi në Fletoren Zyrtare të vendimit nr.190, datë 16.06.2008 nuk përbën vetëm një shkelje të Rregullores së Kuvendit, por dhe marrje arbitrare të një prej kompetencave më të qenësishme të Kuvendit nga Kryetarja e Kuvendit, duke sjellë si pasojë lindjen e konfliktit midis vendimmarrjes së Kuvendit, të shpallur në seancë plenare, dhe funksionit të Kryetares së tij, e cila ka për detyrë të drejtojë punimet e Kuvendit, por në asnjë rast, të interpretojë apo të ndryshojë vendimet e Kuvendit.

II

1. Lidhur me legjitimimin e subjekteve të interesuara

Paraprakisht, Gjykata Kushtetuese (Gjykata), mori në shqyrtim në seancë plenare, kërkesën e përfaqësuesit të subjektit të interesuar, Kuvendit, për moslegjitimimin si subjekte të interesuara të Presidentit të Republikës dhe shtetasit Zamir Poda, pasi sipas tij, neni 39 dhe 71 i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, këto subjekte nuk i përcakton si palë për të marrë pjesë në gjykim kushtetues.

Gjykata thekson se është në diskrecionin e saj të vendosë mbi kategoritë e subjekteve që thirren si subjekte të interesuara në çështje me interes publik. Ligji për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, në nenin 39, shkronja “b”, “c” dhe “ç” nuk i parashikon subjektet e interesuara në mënyrë shteruese, por përcakton kriterin e “interesit të drejtpërdrejtë” që duhet të ketë subjekti për çështjen që shqyrtohet. Në vlerësimin e interesit të kërkuarit për të vënë në lëvizje Gjykatën dhe interesit të drejtpërdrejtë të subjektit të interesuar, respektohen kritere të ndryshme. Në çështjet me interes publik, interesi i drejtpërdrejtë i subjekteve të interesuara duhet kuptuar dhe si interes për të kontribuar në vendimmarrjen e kësaj Gjykate për çështjen që shqyrtohet. Kështu, vlerësimi i legjitimitetit të subjektit të interesuar bazohet jo vetëm në interes të subjektit, por dhe të gjykimit kushtetues. Në këtë vështrim, në gjykimet kushtetuese legjitimohen si subjekte të interesuara ato subjekte që, për shkak të veprimtarisë apo rrethanave, mund të kontribuojnë në shqyrtimin e çështjes që po gjykohet, pavarësisht nëse thirren në gjykim me kërkesën e kërkuarit apo dhe kryesisht nga Gjykata. Në përfundim, ndonëse subjektet e interesuara kanë status të ndryshëm, në çështjen objekt gjykimi, Gjykata vlerëson se, në interes të gjykimit, ata legjitimohen të marrin pjesë në gjykim si subjekte të interesuara.

2. Lidhur me kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 190, datë 16.06.2008 të Kuvendit deri në dhënien e vendimit përfundimtar

Kërkesa e paraqitur nga kërkuari nuk përmban asnjë argument në lidhje me pasojat që mund të sjellë vendimi i Kuvendit, konkretisht cenimin e interesave shtetërorë, shoqërorë ose të individëve, kritere këto të përcaktuara në nenin 45 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkesa për pezullim të ekzekutimit të zbatimit të vendimit nr.190, datë 16.06.2008 të Kuvendit duhet rrëzuar si e pabazuar.

III

Lidhur me interpretimin e pikës 1 të nenit 78 të Kushtetutës

Sipas kërkuarit, Kuvendi, gjatë vendimmarrjes së tij rast pas rasti, ka interpretuar në mënyra të ndryshme kuptimin dhe përmbajtjen e nenit 78, pika 1 të Kushtetutës. Po sipas kërkuarit, togfjalëshi “shumicë votash” ka kuptimin se shumica e votave nuk duhet të llogaritet as “mbi të gjithë anëtarët” dhe as “mbi të gjithë pjesëmarrësit” në votim, por mbi votat e vlefshme.

Lidhur me interpretimin e nenit 78, pika 1 të Kushtetutës, qëndrim të njëjtë me kërkuarin ka parashtruar dhe subjekti i interesuar Zamir Poda. Sipas tij, “shumica e votave” nuk duhet lidhur me kuorumin e pjesëmarrësve në votim, por mbi votat e vlefshme të atyre që marrin pjesë në votim dhe “abstenimi” dhe “vota e pavlefshme” nuk duhen marrë parasysh, sepse në këto raste deputeti nuk shpreh vullnetin e tij me votë “pro” ose “kundër”.

Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka pretenduar se neni 78, pika 1 e Kushtetutës kërkon që ligjet, vendimet, deklaratat dhe rezolutat të miratohen kur votojnë “pro” shumica e deputetëve të pranishëm dhe në asnjë rast, kjo shumicë nuk llogaritet mbi votat e vlefshme.

Në nenin 78, pika 1 të Kushtetutës parashikohet se: *“Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar”*.

Gjykata rithekson se çdo dispozitë e Kushtetutës duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese. Kjo për arsye se, çdo dispozitë kushtetuese ka një lidhje të caktuar me dispozitat e tjera dhe së bashku, ato formojnë një tërësi normash të harmonizuara. (Shih vendimin nr.2, datë 19.01.2005 të Gjykatës Kushtetuese). Nëpërmjet interpretimit që u bën dispozitave apo termave konkretë të Kushtetutës, Gjykata synon të përcaktojë

detyrimet dhe kërkesat që Kushtetuta ia imponon Kuvendit në ushtrimin e veprimtarisë së tij vendimmarrëse.

Gjykata vlerëson të shprehet fillimisht për lidhjen që ekziston midis nenit 78, pika 1 të Kushtetutës dhe parimeve të sanksionuara nga nenet 1, 2 dhe 4 të Kushtetutës. Kjo për arsye se norma kushtetuese që përcakton rregulla për vendimmarrjen e Kuvendit nuk mund të interpretohet si një normë e izoluar, por duhet parë në harmoni me normat që sanksionojnë parimin e sovranitetit të popullit dhe shtetit të së drejtës. Kështu, në nenin 1/1 përcaktohet se: “Shqipëria është Republikë parlamentare”; në nenin 2, përcaktohet se: “1. Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit. 2. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërdrejt”; ndërsa në nenin 4/1 përcaktohet se: “E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit”. Por Kushtetuta nuk është mjaftuar vetëm me sanksionimin e këtyre parimeve të rëndësishëm dhe, në një sërë dispozitash, ka përcaktuar mënyrën dhe rrethanat në të cilat ato ushtrohen apo gjejnë zbatim. Për këto arsye, Kuvendi si organ përfaqësues i popullit, në veprimtarinë që lidhet me *funksionin e tij ligjvënës* (miratimi i ligjeve dhe plotësimi i kuadrit kushtetues dhe ligjor të nevojshëm për funksionimin demokratik të shtetit dhe jetës shoqërore); me *funksionin e tij zgjedhës* (zgjedhja e disa prej funksionarëve më të lartë të shtetit, ku përfshihet edhe dhënia e pëlqimit për anëtarët e Gjykatës së Lartë); si dhe me *funksionin e formimit të vullnetit politik* (përplasja e vullneteve politike të forcave të ndryshme parlamentare), duhet të udhëhiqet nga parimet kryesore të shtetit të së drejtës, një nga të cilët është edhe domosdoshmëria e nxjerrjes së akteve juridike sipas procedurave kushtetuese e ligjore. Respektimi i këtyre procedurave është një parakusht për legjitimitetin e këtyre akteve.

Në themel të procesit ligjvënës qëndron nxjerrja e akteve juridike, të cilat duhet të karakterizohen nga vijueshmëria dhe stabiliteti. Vendimi i Kuvendit është rezultat përfundimtar i diskutimeve parlamentare dhe miratimi i tij duhet të arrihet vetëm nëpërmjet një procesi të rregullt procedural. Mekanizmi kushtetues dhe ligjor që përdoret nga ligjvënësi për të arritur në vendimmarrje është votimi dhe për këtë arsye, procedurave në procesin e vendimmarrjes iu duhet kushtuar vëmendje e veçantë.

Në funksion të interpretimit të dispozitës kushtetuese, objekt gjykimi, vlerësohet e nevojshme të analizohet kuptimi dhe përmbajtja e pjesës së fjalisë së nenit 78, pika 1 të Kushtetutës: “... në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij”.

Sipas rregullit të përgjithshëm, organet kolegjiale e ushtrojnë veprimtarinë e tyre me praninë e të gjithë anëtarëve, por edhe me një anëtarësi më të pakët në numër. Në aktet e krijimit të tyre përcaktohen rregulla që kanë të bëjnë me numrin e anëtarëve që duhet të jenë të pranishëm, të cilët autorizohen për të vepruar në emër të organit kolegjial. Numri minimal i anëtarëve që duhet të jenë të pranishëm dhe që autorizohen për të vepruar në emër të organit quhet kuorum (përveç rastit kur një numri më të vogël i është dhënë kompetenca nga vetë organi ose kur një numër më i madh kërkohet veçanërisht). Kuorumi vendoset për të përcaktuar numrin minimal ose përqindjen e anëtarëve që duhet të jenë të pranishëm në çdo vendimmarrje të organit dhe që kanë autoritetin (autorizohen), për të marrë vendim në emër të të gjithë anëtarëve.

Sipas Kushtetutës, Kuvendi i RSH është krijuar, organizuar dhe funksionon si një organ kushtetues kolegjial. Neni 64, pika 1 e Kushtetutës përcakton se “Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë.” Ndërsa neni 78, pika 1 e Kushtetutës parashikon rregulla për vendimet e Kuvendit që merren në praninë e më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përveç rasteve për të cilat Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar.

Gjykata vlerëson se prania e më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit në marrjen e vendimeve është parashikuar për dy arsye: së pari, për të siguruar legjitimitetin e vendimmarrjes së Kuvendit, pasi duke pasur një numër më të madh të deputetëve që marrin pjesë aktive, vendimi që merret mbështetet në një bazë më të qëndrueshme; së dyti, për të siguruar një vendimmarrje sa më cilësore dhe racionale, duke qenë se është marrë nga një bazë më e gjerë deputetësh të pranishëm.

Në interpretim të dy dispozitave të mësipërme rezulton se numri i anëtarëve që duhet të jenë të pranishëm për zhvillimin e procedurave të vendimmarrjes është të paktën gjysma plus një e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, minimalisht 71 deputetë (kuorumi). Prania e më shumë se gjysmës së

të gjithë anëtarëve të Kuvendit në çdo seancë vendimmarrje është absolutisht e nevojshme për vlefshmërinë e vendimeve që merr ky organ sipas përcaktimeve të nenit 78/1 të Kushtetutës. Numri i deputetëve të pranishëm për marrjen e vendimeve të Kuvendit mund të variojë nga 71 deri në 140 deputetë.

Prania e deputetëve në vendimmarrje sanksionohet në funksion të ushtrimit të funksioneve kushtetuese të vetë organit. Nga ky këndvështrim, deputetët e pranishëm duhet të marrin pjesë në vendimmarrje në mënyrë që të garantohet ushtrimi i funksioneve kushtetuese të Kuvendit. Neni 1 i ligjit “Për statusin e deputetit” parashikon se deputeti është përfaqësues i popullit në organin ligjvënës, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, se deputeti vepron në emër të Kushtetutës dhe ligjeve, i përbahet betimit të tij dhe, në ushtrimin e mandatit kushtetues që i kanë dhënë zgjedhësit, ka detyrimin për të marrë pjesë rregullisht në seanca plenare, në komisione si dhe në të gjithë veprimtarinë e Kuvendit, në përputhje me kërkesat e Rregullores së Kuvendit. Nisur nga ky koncept kushtetues, pjesëmarrja e deputetit në procesin vendimmarrës në seanca plenare të Kuvendit, nuk përbën vetëm një të drejtë të tij, por njëkohësisht, dhe një detyrim që rrjedh nga roli i tij si përfaqësues. Kjo do të thotë që deputetët, të cilët deklarohen të pranishëm në seancë, duhet të japin kontributin e tyre në formimin e vullnetit të organit kolegjial, duke votuar sipas përcaktimeve në Rregulloren e Kuvendit.

Nisur nga kuptimi kushtetues lidhur me praninë e deputetëve në procesin vendimmarrës, si dhe nga detyrimi i tyre si përfaqësues për të votuar, konkludohet se çdo rritje e pranisë në procesin e votimit mbi kuorumin e domosdoshëm sjell rritje të numrit të anëtarëve që votojnë (votes). Numri i anëtarëve të pranishëm verifikohet për efekt të vlefshmërisë së vendimit dhe për të llogaritur rezultatin përfundimtar, që do të thotë, se prania e deputetëve, në çdo rast, përcakton shumicën e votave që duhen për marrjen e vendimit të Kuvendit. Rregulli i mësipërm duhet kuptuar se, kur në seancën për marrjen e vendimit janë të pranishëm 71 deputetë, vendimi konsiderohet i miratuar kur për të kanë votuar pro jo më pak se 36 deputetë. Çdo rritje e numrit të të pranishmëve, domosdoshmërisht shoqërohet me rritje të numrit të nevojshëm të votave pro për miratimin e vendimit.

Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se, në kuptim të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, *shumica e votave* të kërkuara për marrjen e vendimeve nga Kuvendi është të paktën gjysma plus një e të gjithë anëtarëve të pranishëm.

Në përfundim, Gjykata arrin në konkluzionin se pika 1 e nenit 78 të Kushtetutës, në të cilin përcaktohet se: “Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij” duhet interpretuar si vijon:

1. Numri i deputetëve të pranishëm për çeljen e seancës së votimit parlamentar është minimalisht 71 deputetë.

2. Vendimi i Kuvendit miratohet kur për të kanë votuar *pro* jo më pak se gjysma plus një e anëtarëve që janë të pranishëm.

IV

Lidhur me interpretimin e nenit 55/1 Rregullores së Kuvendit

Kërkuar pretendon se interpretimi i nenit 55/1 të Rregullores së Kuvendit është i nevojshëm për faktin se përmban një rregullim të nivelit kushtetues, pasi në të përcaktohen rregulla për vënien në zbatim të nenit 78, pika 1 të Kushtetutës. Në nenin 55/1 të Rregullores përcaktohet se: “*Ligjet, vendimet, deklaratat dhe rezolutat konsiderohen të miratuara nga Kuvendi, kur për to kanë votuar pro shumica e deputetëve, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit, me përjashtim të rasteve kur në Kushtetutë parashikohet shumicë e cilësuar për miratimin e tyre*”.

Kushtetuta në nenin 75/2 sanksionon se: “*Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve*”. Nisur nga rregullimi që përmban kjo normë kushtetuese, dhe më parë Gjykata ka theksuar se Rregullorja e Kuvendit është një akt që disiplinon procedurën për zhvillimin e punimeve të Kuvendit, organizimin e brendshëm, raportet midis vetë Kuvendit si tërësi e organizmave të tij të brendshëm, raportet e tij me organet e tjera kushtetuese etj. Një pjesë e dispozitave të Rregullores janë në përmbajtje të njëjta me dispozitat kushtetuese, ndërsa disa të tjera janë norma ekzekutive të normave kushtetuese, që përcaktojnë

rregullat se si vihen në jetë normat kushtetuese. Kuvendi është organi, që me rregullore, interpreton jo vetëm normat kushtetuese, por edhe normat e tjera të rregullores së tij në praktikën e rasteve konkrete. (Shih vendimin nr. 21, datë 01.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese)

Gjykata Kushtetuese ushtron veprimtarinë e saj brenda juridiksionit të përcaktuar në Kushtetutë dhe konkretisht, në nenin 124 të saj, në të cilin parashikohet se “*Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës*”. Nisur nga përmbajtja dhe kuptimi i kësaj norme kushtetuese, Gjykata vlerëson se ka në kompetencë interpretimin përfundimtar vetëm të Kushtetutës dhe jo interpretimin e akteve me karakter normativ, siç është dhe Rregullorja e Kuvendit. Nisur nga karakteri normativ i saj dhe referuar nenit 131, germa “c” të Kushtetutës, Rregullorja, mund të jetë vetëm objekt i kontrollit kushtetues në rastet kur dispozita të nivelit kushtetues, të përfshira në të, janë të papajtueshme me Kushtetutën.

Si përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për interpretimin e nenit 55, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, nuk është në juridiksionin e saj.

V

Lidhur me shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Kuvendit, nr.190, datë 16.06.2008

Sipas kërkuarit, vendimi i botuar ka shtrembëruar vullnetin e Kuvendit për dekretin e Presidentit, gjë që ka çuar në konflikt kompetencash midis Kuvendit të Shqipërisë dhe Kryetares së tij. Deputetët e Kuvendit nuk mund të pengohen të kundërshtojnë shtrembërimet që i bëhen vullnetit të Kuvendit si përfaqësues i pushtetit legjislativ në shprehjen dhe publikimin e këtij vullneti.

Kushtetuta në nenin 131 shkronja “ç” parashikon juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin në sferën e ndarjes së pushteteve në rrafsh horizontal (ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor) dhe në rrafsh vertikal (pushtet qendror-qeverisje vendore). Mbështetur në jurisprudencën kushtetuese, kjo dispozitë përfshin edhe një gamë tjetër mosmarrëveshjesh, siç janë ato që mund të lindin midis organeve a subjekteve që nuk bëjnë pjesë, në mënyrë kategorikisht të përcaktuar, në njërin apo tjetrin pushtet, si Presidenti, Gjykata Kushtetuese, prokuroria dhe organe të tjera kushtetuese.

Që një mosmarrëveshje kompetence të përfshihet në juridiksionin kushtetues duhet që ajo të lindë ndërmjet organeve që iu përkasin pushteteve të ndryshme dhe që, secili prej tyre, të kërkojë veçmas tjetrit të materializojë vullnetin e pushtetit të cilit i përket, duke nxjerrë akte që ai çmon se i takojnë sferës së vet të kompetencave. Gjykata, në praktikën e saj, ka zgjidhur konflikt kompetencash edhe midis organit kushtetues nga njëra anë dhe një pjese të po këtij organi nga ana tjetër. Ndonëse brenda të njëjtit pushtet, atij legjislativ, pakicës parlamentare i është njohur autoriteti kushtetues i pavarur dhe i pakufizuar nga vullneti i shumicës, për të ushtruar kompetencën e parashikuar nga neni 77 pika 2 e Kushtetutës. (Shih vendimin nr. 26, datë 04.12.2006; nr. 29, datë 21.12.2006; nr.19, datë 03.05.2007; nr. 20, datë 04.05. 2007; dhe nr.12, datë 20.05.2008 të Gjykatës Kushtetuese).

Jurisprudenca kushtetuese ka pranuar se çdo organ pushteti legjitimohet të bëjë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese kur pretendon se ndodhet përpara një konflikti kompetence, i cili mund të ketë lindur për shkak të ligjit apo të një veprimtarie konkrete. Përcaktuese është që sfera e kompetencave të organeve apo subjekteve të konfliktuara duhet të jetë e përkufizuar nga norma kushtetuese.

Gjykata vlerëson se organi, të cilit Kushtetuta i ka njohur kompetencën për të dhënë pëlqimin për dekretin e Presidentit për emërimin e anëtarit të Gjykatës së Lartë është Kuvendi (neni 136, pika 1). Kushtetuta nuk i njeh një të pestës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit të drejtën e materializimit veçmas, të vullnetit në lidhje me këtë vendimmarrje, pasi kjo e drejtë i takon ekskluzivisht organit ligjvënës si një i tërë. Kërkuari nuk mund të pretendojë kufizimin apo mohimin e një të drejte, përsa kohë e drejta nuk buron nga normat kushtetuese. Në këtë vështrim, kërkuari nuk legjitimohet në kërkimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës.

Përveç sa më sipër, Gjykata vlerëson se çështja, objekt shqyrtimi, ka tiparet e një gjykimi abstrakt, pasi në vështrim të nenit 131, pika ç të Kushtetutës, gjykimi kushtetues i konfliktit të kompetencave synon zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis organeve kushtetuese për kompetenca të parashikuara shprehimisht nga Kushtetuta.

Gjykata është shprehur dhe më parë, se në gjykimet me karakter abstrakt, ajo nuk ka juridiksion të kontrollojë aktet me natyrë individuale. Duke qenë se vendimi i Kuvendit, objekt shqyrtimi, pasqyron vullnetin e Kuvendit për mosdhënien e pëlqimit për emërimin e një anëtarit të Gjykatës së Lartë, Gjykata pranon se ky akt ka karakter individual. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se nuk ka juridiksion të kontrollojë vendimit të Kuvendit, nr. 190, datë 16.06.2008.

Si përfundim, Gjykata arrin në konkluzionin se kërkesa e iniciuar nga grupi prej jo më pak se një e pesta e deputetëve (1/5) lidhur me shfuqizimin e vendimit të Kuvendit, nr. 190, datë 16.06.2008 duhet rrëzuar për mungesë legjitimitimi të kërkuarit dhe mungesë juridiksioni të kësaj Gjykate.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja “ç” dhe 134, pika 1, shkronja “c” të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

Interpretimin e pikës 1 të nenit 78 të Kushtetutës si vijon:

1. Numri i deputetëve të pranishëm për çeljen e seancës së votimit parlamentar është minimalisht 71 deputetë.

2. Vendimi i Kuvendit miratohet kur për të kanë votuar pro jo më pak se gjysma plus një e anëtarëve që janë të pranishëm.

- Rrëzimin e kërkesës për çështjet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Gjergj Sauli, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Vitore Tusha, Sokol Berberi.

Anëtarë kundër: Fehmi Abdiu, Kujtim Puto, Sokol Sadushi.

MENDIMI I PAKICËS

Interpretimi përfundimtar i Kushtetutës përbën funksionin bazë të organit që realizon drejtësinë kushtetuese. Prandaj dhe kompetencat që i janë ngarkuar Gjykatës Kushtetuese, sipas nenit 131 dhe që përbën legjitimitetin e saj, janë për të interpretuar në mënyrë përfundimtare Kushtetutën, nga e cila zbulohet përmbajtja e vërtetë e parimeve dhe e dispozitave konkrete kushtetuese. Interpretimet përfundimtare të formuluar nga Gjykata Kushtetuese, kur ajo e interpreton Kushtetutën konsiderohen si “kushtetutë e gjallë dhe japin kontributin thelbësor për krijimin dhe zhvillimin e doktrinës kushtetuese.

Neni 78 i Kushtetutës që parashikon se *“Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar.”*, ka ndarë në dy qëndrime të kundërta gjyqtarët kushtetues gjatë interpretimit përfundimtar të tij. Si shkak për lindjen e mosmarrëveshjes në interpretimin e kësaj dispozite kushtetuese ka shërbyer procedura parlamentare e zhvilluar për dhënien e pëlqimit të dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e z.Zamir Poda si gjyqtar i Gjykatës së Lartë. Kryetari i Sekretariatit për Procedurat e Votimit, duke iu referuar nenit 78 të Kushtetutës, ka shpallur dy vendime të ndryshme të votimit të zhvilluar në Kuvend, të cilat kanë qenë rrjedhojë e interpretimeve të kundërta, që i janë bërë rezultatit të votimit të 65 votave *“pro”*, 62 votave *“kundër”*, 1 votë *“abstenim”* dhe 2 votave të pavlefshme. Vendimi përfundimtar që ka shpallur Kuvendi, për mos dhënien e pëlqimit të dekretit të Presidentit të Republikës, ka shërbyer si indicie për një grup deputetësh për t’i kërkuar Gjykatës Kushtetuese kryerjen e interpretimit përfundimtar, në nenin 78 të Kushtetutës, të frazës *“Kuvendi vendos me shumicën e votave...”*.

Gjykata Kushtetuese, ka pranuar të kryejë interpretimin përfundimtar të nenit 78 të Kushtetutës, por përfundimi në të cilin ajo ka arritur, në analizën e gjyqtarëve në pakicë, jo vetëm nuk është i plotë, por njëkohësisht përbën dhe një devijim nga kërkesa për interpretimin e frazës së kërkuar nga kërkuesi. Interpretimin e të gjithë nenit 78 të Kushtetutës, shumica në dispozitivin e vendimit të saj e ka përmbledhur vetëm në këto dy fjali: *“Numri i deputetëve të pranishëm për çeljen e seancës së votimit parlamentar është minimalisht 71 deputetë. Vendimi i Kuvendit miratohet kur për të kanë votuar pro jo më pak se gjysma plus një e anëtarëve që janë të pranishëm.”*

Gjyqtarët në pakicë janë të mendimit se ky interpretim i shumicës nuk është tërësor, por i pjesshëm. Interpretimi kushtetues i bërë prezent në seancën parlamentare, lidhur me mosdhënien nga Kuvendi të pëlqimit për dekretin e Presidentit të Republikës për emërimin e z. Zamir Poda si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, si dhe qëndrimi i kundërt interpretues që mban kërkuesi, nuk kanë pasur si shkak të krijimit të konfliktit interpretimin e ndryshëm të frazës *“...në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij”*, që ka kryer Gjykata Kushtetuese, por interpretimin e frazës *“Kuvendi vendos me shumicën e votave...”*. Gjithashtu, edhe objekti kryesor i debatit të zhvilluar ndërmjet subjekteve pjesëmarrëse në seancën plenare, por edhe ndërmjet gjyqtarëve kushtetues, në dhomën e bisedimit ka qenë i fokusuar në kuptimin e saktë që duhet të ketë fraza kushtetuese *“shumicë votash”*. Interpretimi përfundimtar që i ka bërë shumica vetëm gjysmës së dytë të fjalisë së parë të nenit 78 të Kushtetutës dhe që lidhet me përcaktimin e numrit minimal prej 71 deputetësh për të çelur seancën e votimit parlamentar, nuk ka qenë shkak për lindjen e ndonjë konflikt me natyrë kushtetuese, për arsye se subjektet pjesëmarrëse në proces nuk e kanë kërkuar dhe as debatuar atë ndërmjet tyre. Një interpretim i paplotë, i kryer nga shumica dhe që nuk zgjidh përfundimisht mosmarrëveshjen e krijuar, si në rastin në shqyrtim, ashtu edhe për të ardhmen, lidhur me termin shumicë votash, përbën dhe arsyen kryesore të qëndrimit të kundërt që mbajnë gjyqtarët në pakicë. Prandaj, pakica është e mendimit se shkaku kryesor që ka krijuar mosmarrëveshje në interpretimin dhe në zbatimin e ndryshëm të nenit 78 të Kushtetutës ka qenë mosinterpretimi korrekt i konceptit votë, mbi të cilat duhet lexuar fraza kushtetuese *“shumicë votash”*.

Në vështrim të parë duket sikur Kushtetuta në nenin 78 të saj ka ometuar duke mos e qartësuar apo saktësuar llojin dhe natyrën ligjore të votës, ndërkohë që neni 55 i Rregullores së Kuvendit parashikon se *“fletët e votimit të fshehtë duhet të përmbajnë të paktën ...alternativat e votimit pro, kundër dhe abstenim”*. Pra, interpretimet e kundërta të frazës kushtetuese *“shumicë votash”* kanë qenë të përqendruara në dilemat, nëse leximi i rezultatit të votimit, duhet të bëhej vetëm mbi votat që, në kuptim të Kushtetutës dhe të Rregullores së Kuvendit, konsiderohen të vlefshme (*pro, kundër dhe abstenin*), apo edhe mbi votat e pavlefshme. Pikërisht, interpretimi kushtetues në pikën e dytë të dispozitivit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese që përcakton se *“Vendimi i Kuvendit miratohet kur për të kanë votuar pro, jo më pak se gjysma plus një e anëtarëve që janë të pranishëm”*, duke mos qenë një interpretim i plotë, ka lënë të pazgjidhur mënyrën e vlerësimit të votës, si për rastin konkret, ashtu edhe për mosmarrëveshjet që mund të lindin në të ardhmen. Një interpretim i tillë ka krijuar praktikën e gabuar për vlerësimin e votës së pavlefshme si votë të numërueshme, mbi të cilën do të llogaritet shumica e votave të të pranishmëve.

Gjyqtarët në pakicë janë të mendimit se fraza kushtetuese *“me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij...”* nuk merr të njëjtin kuptim me interpretimin që Gjykata Kushtetuese i ka bërë shumicës së të pranishmëve. Fakti që neni 78 i Kushtetutës flet për *“shumicë votash”* në aspektin literal, mbart dhe aspektin konceptual brënda saj. Fraza *“shumicë votash”* nuk mund të interpretohet dhe të identifikohet si *“shumicë e të pranishmëve”* sikundër është shprehur shumica. Nëse hartuesit e Kushtetutës, në nenin 78, do të kishin dashur të njehsonin termin *“votë”* me termin *“të pranishëm”*, atëherë do të kishin përdorur të njëjtën terminologji të qartë sikundër e kanë përdorur në dispozita të tjera kushtetuese, si p.sh. në nenin 81/2, që ka parashikuar se ligjet *“miratohen me tri të pestat e anëtarëve të Kuvendit”*, apo në nenin 85/2 që shprehet se për ligjet e kthyera nga Presidenti i Republikës *“votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit”*, etj.

Fraza të tilla kushtetuese si *“shumicë absolute të të pranishmëve”*, *“votat e shumicës së atyre deputetëve të pranishëm dhe që votojnë.”*, *“shumica e të pranishmëve”*, etj njihen edhe në kushtetutat e vendeve të tjera, ku përdorimi i termit *“shumicë e të pranishmëve”* ka shmangur paqartësitë në zbatimin e normave juridike, duke mos i lënë vend keqinterpretimit apo keqkuptimit

të termit “*shumicë votash*”. Sipas nenit 48 të Rregullores së Dhomës së Deputetëve të parlamentit italian: “... konsiderohen të pranishëm ata që shprehin votën “*në favor*” ose “*kundër*”. Gjithashtu, Karta e Kombeve të Bashkuara (*United Nation Charter*) ofron një koncept të “*shumicës*”, sipas të cilës, shumica e kërkuar për një miratim vendimi, llogaritet mbi bazën e numrit të votave “*pro*” dhe “*kundër*”, ndërsa anëtarët që abstenojnë nuk konsiderohen votues.

Gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se koncepti “*shumicë e votave të të pranishmëve*”, siç arsyeton shumica e Gjykatës Kushtetuese, krijon një lloj konfondimi, sepse nga njëra anë, termi “*të pranishëm*” nuk do të thotë se të gjithë deputetët e pranishëm domosdoshmërisht votojnë dhe, nga ana tjetër, nuk e bën të mundur leximin saktësisht të votës së deputetit, për shkak të përfshirjes në këtë koncept edhe të votës së pavlefshme. Pikërisht, mos mbajtja e një qëndrimi të qartë dhe për rrjedhojë mos kryerja e interpretimit të plotë nga Gjykata Kushtetuese për llojin e votave që duhet të përbëjnë shumicën e votave në kuptimin kushtetues, krijon kushtet për të konsideruar si kushtetuese vendimmarrjen parlamentare të marrë mbi leximin edhe të votave të pavlefshme.

Gjyqtarët në pakicë janë të mendimit se interpretimi dhe vlerësimi i shumicës së votës duhet të bëhet vetëm mbi vlefshmërinë e votës. Në kuptimin kushtetues shumica e votave nuk duhet të llogaritet mbi çdo lloj vote, por vetëm mbi konceptin “*votë e vlefshme*”. Vota shpreh një vullnet ligjor e cila ushtrohet për një qëllim të caktuar. Vullnetin e tyre deputetët e pranishëm mund ta shprehin me votë “*pro*”, “*kundër*”, ose me “*abstenim*”. Këto janë tri mënyra të shfaqjes së vullnetit të deputetit, që parashikohen në nenin 55 të Rregullores së Kuvendit dhe që konsiderohen si një vullnet i shpallur në mënyrë të ligjshme prej tij. Pavarësisht nga mënyra e votimit “*pro*”, “*kundër*” ose “*abstenim*”, në çdo rast vota konsiderohet e vlefshme. Mbi këtë koncept ligjor për votën arrihet edhe një vendimmarrje kushtetuese e caktuar. Ndërkohë që pavlefshmëria, si koncept juridik nuk është vullnet, por veçse një nulitet i plotë, mbi të cilin nuk mund të konkludohet për një vendimmarrje të ligjshme. Vota e pavlefshme nuk arrin të përçojë shprehje apo shfaqje vullneti në asnjë aspekt. Vota e pavlefshme nuk është votë, mbi të cilën mund të llogaritet një shumicë e votave.

Interpretimi i kryer nga shumica se “*Vendimi i Kuvendit miratohet kur për të kanë votuar pro jo më pak se gjysma plus një e anëtarëve që janë të pranishëm*”, e ka prezumuar leximin e votës së pavlefshme si votë kundër. Vota e pavlefshme nuk mund të konsiderohet si votë kundër, për arsye se mundësinë e shprehjes së vullnetit në mënyrë negative, deputetët që votojnë e përmbushin me alternativën e votimit “*kundër*”. Njëkohësisht vota e pavlefshme nuk mund të lexohet as si votë “*pro*”. E vetmja mënyrë për të lexuar votën e pavlefshme është mosllogaritja e saj, për arsye se ajo mbart në vetvete, si mundësinë e votimit “*pro*” ashtu edhe të votimit “*kundër*”. Edhe Rregullorja e Kuvendit, në nenin 60 të saj, duke mos dhënë asnjë interpretim për “*votën e pavlefshme*” ka përcaktuar konceptin e votës së vlefshme në të tri alternativat e votimit pro, kundër dhe abstenim. Pra, të vepruarit në ndryshim nga këto mënyra, e bëjnë votën të pavlefshme dhe, për rrjedhojë, të panumërueshme si votë pro, kundër dhe abstenim. Edhe “*abstenimi*” është një mënyrë e shprehjes së vullnetit, ndërkohë që te vota e pavlefshme mungon elementi i shprehjes së vullnetit. Vota e pavlefshme është veçse pavlefshmëri dhe si e tillë nuk mund të jetë dhe nuk mund të llogaritet as votë pro dhe as votë kundër. Të vlerësosh shumicën e votave për arritjen e një vendimmarrje të caktuar edhe mbi votat e pavlefshme, siç ka bërë shumica në rastin në shqyrtim, do të thotë t’i japësh nulitetit vlerë kushtetuese.

Mbi këtë analizë, gjyqtarët në pakicë janë të mendimit se Gjykata Kushtetuese, nëpërmjet interpretimit tërësor dhe përfundimtar të nenit 78 të Kushtetutës, duhej të mënjanonte nga vendimmarrja kushtetuese e Kuvendit vlerësimin e votës së pavlefshme dhe llogaritjen e saj në konceptin “*shumicë votash*”.

Anëtarë: Sokol Sadushi, Kujtim Puto, Fehmi Abdiu

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori). Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 13.11.2009
Doli nga shtypi më 16.11.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 32 lekë